

## AKT- THEMELIMI

### I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË

#### KUFIZUAR

#### “BIG PAJTONI” Sh.p.k.

#### Midis:

1. Shoqëria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Tregëtar në QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli në *Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Çash & Carry, kati 2*. Me përfaqësuese Ligjore Znj. Elona Koshi, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, e lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, Rruga “3 Dëshmorët”, Yzberisht. Madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 lëshuar më datë 06.06.2017.
2. **Z Robert Hoxha**, i datëlindjes 11.06.1979, lindur në Librazhd, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe nr personal ID H90611075R.

Në bazë të legjislacionit shqiptar kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, marrëveshjen për themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar **“BIG PAJTONI” Sh.p.k.** e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

#### Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “Big Pajtoni” Sh.p.k. “Big Pajtoni” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrorë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Shoqëria “Big Pajtoni” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

#### Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

#### Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Import-eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë si:

- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
- Tregëtim fruta-perime;
- Tregëtim pije alkolike të ndryshme;
- Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe femijë;
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike;
- Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit;
- Tregëtim automjetesh të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
- Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyresh etj;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;
- Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë.
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm kancelarik, libra, revista etj"

#### Neni 4

Shoqëria "Big Pajtoni" Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: *Lagjja Fushe Mezes, Autostrada Tirane Durrës, Km.1, Qendra Pajtoni Business Center, Kati 0, Z. K 2679, N. P 164/63-N12. Rr industriale dytesore, Kashar, Mezez, Tirane.*

#### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë "Big Pajtoni" Sh.p.k. do të jetë **25,000,000 leke (njëzetë e pesë milionë)** dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

#### Neni 6

Palët kontraktuese kanë rënë dakort të përcaktojnë kuotën e pjesmarrjes të secilit ortak si më poshtë:

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
<b>BIGALB GROUP Sh.p.k.</b>		<b>51%</b>	<b>12 750 000</b>
<b>ROBERT HOXHA</b>		<b>49%</b>	<b>12 250 000</b>

#### **Neni 7**

Kohëzgjatja e shoqërisë “Big Pajtoni” Sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

#### **Neni 8**

I gjithë kapitali i vënë nga të dy ortakët themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

#### **Neni 9**

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregëtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga të dy ortakët. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

#### **Neni 10**

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen pjesërisht ose totalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të tyre të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjane të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

#### **Neni 11**

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do të ndahet proporcionalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

#### **Neni 12**

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 13**

Ortakët kanë këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhin kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqin fitimin e realizuar,



- të tërheqin aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohen për arritjen e objektivave të shoqërisë.

#### **Neni 14**

Organet e shoqërisë "Big Pajtoni" Sh.p.k. janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë Administrator i shoqërisë do të jetë **Z Admir Shkempi** për një afat 5 vjecar.

#### **Neni 15**

Shoqëria tregëtare private "Big Pajtoni" Sh.p.k. është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe vecanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

#### **Neni 16**

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

#### **Neni 17**

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

#### **Neni 18**

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar.

#### **Neni 19**

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

24/01/2022  
Datë

**ORTAKËT THEMELUES**

**Shoq. "BIGALB GROUP" Sh.p.k.**

**Përfaqësuese Ligjore**

**Zj. ELONA KOSHI**

*Elona Koshi*

*[Signature]*

**Z ROBERT HOXHA**

*Robert Hoxha*

*[Signature]*